

Në bazë të nenit 16 të Ligjit të Përcaktimit të Çmimeve të Shërbimeve të Ujit ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 7/16), nenit 14 të Rregullores së Mënyrës dhe të Procedurës së Përcaktimit të Tarifës së Shërbimit të Ujit dhe të Tarifës Rregullatore të Shërbimit të Ujit ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 63/17 dhe 128/24), Komisioni Rregullator i Energjetikës, i Shërbimeve të Ujit dhe i Shërbimeve të Menaxhimit me Mbeturina Komunale i Republikës së Maqedonisë Veriut, në seancën e mbajtur më 26 shtator 2024, solli këtë

A K T V E N D I M

për përcaktimin e tarifës rregullatore të trajtimit të ujërave të zeza për NPK "Ujësjiellësi" Koçan për periudhën e rregulluar 2024-2026

1. NPK UJËSJELLËSI Koçan i përcaktohet tarifë rregullatore e shërbimit të ujit të trajtimit të ujërave të zeza edhe atë:
 - për vitin 2024
 - për kategorinë e amvisërive në shumë prej 17,61 den/m³
 - për kategorinë të tjerë në shumë prej 17,61 den/m³
 - për vitin 2025
 - për kategorinë e amvisërive në shumë prej 18,30 den/m³
 - për kategorinë të tjerë në shumë prej 18,30 den/m³
 - për vitin 2026
 - për kategorinë e amvisërive në shumë prej 19,08 den/m³
 - për kategorinë të tjerë në shumë prej 19,08 den/m³
2. Ofruesi i shërbimit të ujit nga pika 1 e këtij aktvendimi duhet t'i zbatojë kushtet në vijim:
 - t'i zbatojë tarifatat e pikës 1 të këtij vendimi dhe
 - të përgatisë dhe të dërgojë deri te Komisioni Rregullator i Energjetikës, i Shërbimeve të Ujit dhe i Shërbimeve të Menaxhimit me Mbeturina Komunale i Republikës së Maqedonisë së Veriut, Planin e Përshtatjes së Tarifave dhe Planin Afarist në pajtim me këtë aktvendim.
3. Detyrohet ofruesi i shërbimit të ujit të dërgojë plan të ri të adaptimit të tarifave të shërbimeve të ujit për periudhën e rregulluar 2027-2029, më së voni në afat prej nëntë muajsh para skadimit të afatit të këtij aktvendimi.

4. Ky aktvendim hyn në fuqi në ditën e sjelljes së tij dhe botohet në “Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut” dhe publikohet në faqen e internetit të Komisionit Rregullator të Energjetikës i të Shërbimeve të Ujit dhe të Shërbimeve të Menaxhimit me Mbeturina Komunale të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

PA1 nr. 08-346/23

26 shtator 2024

Shkup

**Kryetari i Komisionit Rregullator të Energjetikës,
të Shërbimeve të Ujit dhe të Shërbimeve të
Menaxhimit me Mbeturinat Komunale të
Republikës së Maqedonisë së Veriut**

Марко Бислимоски